

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.07.2021*

05.07.2021

Ora 12:08

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr.57”

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje, në datën 05.07.2021, zhvillohet procedura e shortit për përcaktimin e relatorit, për Kërkesën Ankimore nr. 57, të dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 05.07.2021. Procedura e shortit është e njëjtë si procedurat e tjera. Referuar nenit 14 të rregullores së KAS-it, kemi 5 shirita letre, në një të cilave është vendosur Kërkesa Ankimore nr. 57. Katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Pasi palosen, vendosen në 5 gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë, të cilat janë në një enë transparente dhe përziejhen nga një përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm dhe kanë dhënë autorizimin për të zhvilluar shortin dhe për të tërhequr goglat, për llogari të tyre. Pasi janë futur 5 shiritat e letrës në goglat me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë në enë transparente, trazohen nga një përfaqësues i KQZ-së dhe vazhdon tërheqja në emër dhe për llogari të anëtarëve të KAS-it, duke filluar nga rendi alfabetik rritës, nga zoti Elvin Lako. Tërhiqet gogla në emër të zotit Elvin Lako.

Z. E. Lako: Tërheq gogllën 1 - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.57. Relatori i Kërkesës Ankimore nr.57 është zoti Elvin Lako.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.07.2021**

Z. E. Çefa: Tërheq goglën 2 - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Z. I. Rusmali: Tërheq goglën 3 - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Z. K. Bele: Tërheq goglën 4 - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Z. L. Braho: Tërheq goglën 5 - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Atëherë, rezultati i shortit: Relator i Kërkesës Ankimore nr.57 është zoti Elvin Lako, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**

